



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2021

V E N D I M

Nr. 1, datë 08/01/2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 112, datë 08.10.2020, e tre shoqatave, përkatësisht Sindikatës së Punonjësve të Shërbimit Shëndetësor, Qendresës Qytetare dhe Qendrës për të Drejtat në Punë, ku pretendohet diskriminim për shkak se këto subjekte janë organizata te pavarura dhe opozitare ndaj qeverisë, nga ana e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Nga ana e shoqatave të sipërcituara pretendohet se gjatë periudhës së Pandemisë Covid-19, përfaqësuesit e tyre i janë drejtuar disa herë zyrtarisht Policisë së Shtetit, për të siguruar kushtet përkatëse, me qëllim zhvillimin e tubimeve të ndryshme publike, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 8773, datë 23.04.2001 “*Për tubimet*”.

Sipas subjekteve ankuese, dy kërkesat e fundit të Sindikatës së Punonjësve të Shërbimit Shëndetësor dhe Qendresës Qytetare, për të realizuar tubime, janë depozituar pranë Drejtorisë së Policisë Vendore Tiranë gjatë muajit shtator 2020. Njëri prej tubimeve do të organizohej me qëllim kryerjen e një aksioni simbolik për plagjiaturat, ndërkohë që tubimi i dytë ishte protestë “Im Memoriam” në kujtim të punonjësve të sistemit shëndetësor, që kanë humbur jetën gjatë kryerjes së detyrës për shkak të pandemisë së Covid-19. Qëllimi i protestës

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

konsistonte gjithashtu edhe kryerjen e sensibilizimit për paga dhe kushte më të mira pune në sistemin shëndetësor.

Shoqatat ankuese theksojnë faktin se në këto aktivitete ishte parashikuar dhe garantuar marrja e masave të nevojshme për të parandaluar përhapjen dhe infektimin nga Covid – 19 të pjesëmarrësve. Aktivitetet do të zhvilloheshin në ambiente të hapura, pjesëmarrësit do të ruanin distancat e lejuara, si dhe do të përdornin maskat mbrojtëse gjatë gjithë kohëzgjatjes së tubimeve.

Pavarësisht sa më sipër, në datën 23.09.2020, Drejtoria e Policisë Vendore Tiranë ka refuzuar zyrtarisht zhvillimin e këtyre tubimeve, me arsyetimin se mbështetur në pikën 4, të Urdhërit nr. 351, datë 20.05.2020, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, *“Për marrjen e masave të veçanta dhe kufizimeve për parandalimin e përhapjes së Covid-19”*, këto aktivitete përbëjnë rrezik real për shëndetin e qytetarëve.

Shoqatat ankuese theksojnë faktin se Drejtoria e Policisë Vendore Tiranë e ka zbatuar me dy standarde aktin nënligjor të sipërcituar, pasi nga ana e tyre është konstatuar organizimi i eventeve, koncerteve dhe tubimeve të tjera në ambiente të hapura dhe të mbyllura nga përfaqësues të autoriteteve publike në nivel lokal dhe qendror, ndërkohë që shoqatave dhe sindikatave, që luajnë rol opozitar me qeverinë, u mohohet një gjë e tillë. Subjektet ankuese kanë depozituar në cilësi prove, foto nëpërmjet së cilave faktojnë zhvillimin e aktiviteteve të tjera, të tilla si: (1) Evente përuruese të Bashkisë Tiranë, në datat 9 dhe 11 shtator 2020, në ambiente të mbyllura; (2) Ceremonia e prezantimit të forcave “Shqiponja”, në datën 16.09.2020, në formën e një tubimi në ambient të hapur; (3) Takim i strukturave të Partisë Socialiste, organizuar në datën 22.09.2020, në Elbasan, në një ambient gjysëm të hapur dhe pa përdorimin e maskave mbrojtëse²; (4) Takim i Partisë Socialiste, në datën 22.09.2020, në Tiranë, në një ambient të mbyllur, pa përdorimin e maskave mbrojtëse dhe pa ruajtjen e distancës së duhur; (5) Aktivitet i Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, në datën 29.09.2020, gjatë së cilit ndahen certifikatat e pronësisë, në prezencë të individëve të moshës së tretë, pa ruajtjen e distancës dhe pa përdorimin e maskave; (6) Tubim në ambient të hapur të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, në datën 25.09.2020, në Dajt, Tiranë, për ndarjen e lejeve të legalizimit. Në këtë kontekst, këto shoqata pretendojnë diskriminim, nga ana e Drejtorisë së Policisë Vendore Tiranë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

² Referuar shprehimisht titujve mbi fotot e printuara të takimeve dhe aktiviteteve, të depozituara në cilësi prove nga ana e subjekteve ankuese;

Hapat proçeduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 112, datë 08.10.2020, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi proçedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7³, të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua subjekteve përkatëse me shkresën nr. 1355/1, datë 21.10.2020, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:
1. Kopje të të gjithë kërkesave me shkrim për organizim tubimesh dhe aktiviteteve, të depozituara pranë Drejtorisë së Policisë Vendore Tiranë, nga ana e subjekteve ankuese, përgjatë periudhës maj 2020 e në vijim;
 2. Përgjigjet zyrtare të Drejtorisë së Policisë Vendore Tiranë, mbi këto kërkesa;
 3. Informacion mbi numrin e përgjithshëm të kërkesave të depozituara nga ana e subjekteve të ndryshëm (privatë e publikë) për organizim aktiviteteve dhe tubimesh, përgjatë periudhës maj 2020 e në vijim;
 4. Sa prej kërkesave të mësipërme janë miratuar nga Drejtoria e Policisë Vendore Tiranë dhe sa tubime dhe aktivitete janë zhvilluar përgjatë periudhës maj 2020 e në vijim. Të përcillen pranë KMD-së, aktet miratuese të Drejtorisë së Policisë Vendore Tiranë.
 5. Çdo informacion tjetër, që ka lidhje me çështjen objekt ankese.
- Në përgjigje të shkresës nr. 1355/1, datë 21.10.2020, së Komisionerit, Drejtoria e Policisë Vendore Tiranë dërgoi shkresën nr. 7884/1, datë 01.10.2020, nëpërmjet së cilës sqaron se për periudhën nga muaji maj deri në 30 tetor 2020, pranë Drejtorisë së Policisë Vendore Tiranë janë paraqitur 16 kërkesa nga shtetas dhe subjekte të ndryshëm për organizimin e tubimeve.

Në zbatim të nenit 6, të ligjit nr. 8773, datë 23.04.2001 *“Për tubimet”*, por edhe në procedurat standard të punës, strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë i kanë kthyer përgjigje zyrtare subjekteve kërkuuese, duke arsyetuar ndalimin e zhvillimit të tubimit. Referuar neneve

³ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: *“Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”*.

6 dhe 8 të ligjit të sipërcituar, Aktit Normativ nr. 3, datë 15.03.2020, si dhe Urdhërit nr. 351, datë 29.05.2020, të MSHMS zhvillimi i tubimeve në kohë pandemie Covid 19, përbën një rrezik real për shëndetin e individëve.

Në lidhje me pretendimin e shoqatave ankuese se në aktivitete ishte parashikuar dhe garantuar marrja e masave të nevojshme për të parandaluar përhapjen dhe infektimin nga Covid-19 të pjesëmarrësve, duke ruajtur distancat e lejuara si dhe do të përdornin maskat mbrojtëse gjatë gjithë kohëzgjatjes së tubimeve, sqarohet se në shumicën e tubimeve të zhvilluar në qytetin e Tiranës është konstatuar se organizatorët e tyre nuk u përmbahen kërkesave ligjore për mbarëvajtjen e tubimit. Organizatorët e tubimit nuk ia kanë dalë të mbajnë në kontroll veprimet dhe sjelljet e pjesëmarrësve në tubim.

Bazuar në praktikën e rasteve të mëparshme, organizatorët e tubimeve nuk mund të garantojnë dhe kontrollojnë pjesëmarrësit për mbajtjen e maskave mbrojtëse dhe nuk mund të garantojnë në tërësi masat për të parandaluar përhapjen dhe infektimin nga Covid-19 të pjesëmarrësve.

Lidhur me pretendimin e disa shoqatave se Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë ka përdorur dy standarde për sa i përket organizimit të disa eventeve, koncerteve dhe aktiviteteve të organizuara nga përfaqësues të autoriteteve publike në nivel lokal dhe qendror, ndërkohë që shoqatave që luajnë rol opozitar me qeverinë, u mohohet një gjë e tillë, sqarohet se strukturat e D.V.P. Tiranë kanë përdorur një standard për të gjitha subjektet kërkuese, ndalimet e zhvillimit të tubimeve kanë qenë për shkak të pandemisë Covid-19, fakt që reflektohet edhe në praktikën shkresore (në kthimet e përgjigjeve të subjekteve kërkuese). Aktivitetet e cituara në shkresën e KMD-së nuk janë zhvilluar me lejen e strukturave të Drejtorisë së Policisë Tiranë.

Bashkëlidhur shkresës së Drejtorisë së Policisë Tiranë janë dërguar në cilësi prove shkresat përgjigje të këtij institucioni drejtuar subjekteve, që kanë kërkuar organizimin dhe zhvillimin e tubimeve në ambiente publike.

C. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

1. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesit.

Në ankesën nr. 112, datë 08.10.2020, e Sindikatës së Punonjësve të Shërbimit Shëndetësor, Qendresës Qytetare dhe Qendrës për të Drejtat në Punë pretendohet diskriminim, për shkak se

këto subjekte, janë organizata te pavarura dhe opozitare ndaj qeverisë, nga ana e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.

Pretendimi për diskriminim i shoqatave të mësipërme qendron në faktin se Drejtoria e Policisë Vendore Tiranë e ka refuzuar zyrtarisht kërkesat e këtyre shoqatave për zhvillimin e tubimeve në ambiente publike, me arsyetimin se mbështetur në pikën 4, të Urdhërit nr. 351, datë 20.05.2020, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, *“Për marrjen e masave të veçanta dhe kufizimeve për parandalimin e përhapjes së Covid-19”*, këto aktivitete përbëjnë rrezik real për shëndetin e qytetarëve. Shoqatat theksojnë faktin se institucione të ndryshme shtetërore dhe subjekte politike kanë kryer mbledhje apo tubime dhe janë lejuar nga Drejtoria e Policisë Vendore Tiranë, për t'i kryer këto aktivitete, ndërsa subjektet ankuese janë refuzuar pasi ato janë opozitare me qeverinë aktuale.

Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesave, Komisioneri ndjek procedurën ligjore, të parashikuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”* (i ndryshuar). Gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioneri evidenton së pari, nëse subjekti ankuesi është ekspozuar ndaj një qendrimit të padrejtë/të paligjshëm, disfavorizues e të pabarabartë nga ana e subjektit kundër së cilit drejtohet ankesa. Në vijim, Komisioneri reflekton vlefshmërinë ligjore dhe të provuar, të shkakut të diskriminimit. Në përfundim, vërteton duke analizuar provat e mbledhura gjatë hetimit administrativ, nëse ka lidhje shkakësore ndërmjet qendrimit të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë ndaj së cilit subjekti ankues është ekspozuar, me shkakun e diskriminimit të pretenduar.

Fillimisht, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi analizoi legjislacionin përkatës, si dhe provat përkatëse të depozituara nga palët, me qëllim evidentimin e faktit, nëse qendrimi i Drejtorisë së Policisë Vendore Tiranë, ndaj shoqatave ankuese ka qene i padrejtë/i paligjshëm, disfavorizues dhe i pabarabartë, në krahasim me subjekte të tjera, të njëjta, apo të ngjashëm me to.

Zhvillimi dhe organizimi i tubimeve kryhet në bazë të dispozitave përkatëse të ligjit nr.8773, datë 23.4.2001 *“Për tubimet”*, i cili parashikon procedurat përkatëse për miratimin e tyre.

Për sa më sipër, neni 5, i ligjit nr.8773, datë 23.4.2001 *“Për tubimet”* parashikon se në rast tubimi në sheshe ose vendkalime publike, organizatori dhe drejtuesi i tubimit janë të detyruar të njoftojnë me shkrim Shefin e Komisarariatit të Policisë, jo më vonë se tri ditë para datës së zhvillimit të tubimit. Njoftimi me shkrim duhet të përmbajë: a) identitetin dhe adresën e drejtuesit dhe të organizatorit të tubimit; b) qëllimin e tubimit; c) datën, vendin, orën e fillimit dhe të përfundimit të tubimit dhe itinerarin e tij (nëse ka të tillë); ç) numrin e përafërt të

pjesëmarrësve dhe numrin e personave ndihmës në mbarëvajtjen e tubimit; d) personat që do të flasin në tubim. Në rast se njoftimi me shkrim nuk i përmban elementet e parashikuar në pikën 2 të këtij neni, ai i kthehet për plotësim organizatorit dhe drejtuesit të tubimit, të cilët duhet ta riparaqesin atë të plotësuar jo më vonë se 24 orë para kohës kur do të zhvillohet tubimi.

Në vijim, në referencë të nenit 6, të të njëjtit ligj, Shefi i Komisarariatit të Policisë, brenda 24 orëve nga marrja e kërkesës sipas kriterëve të përcaktuara në nenin paraardhës të këtij ligji, me vendim të arsyetuar duhet: a) t'i komunikojë organizatorit ose drejtuesit të tubimit ndalimet dhe kufizimet e mundshme ose kushtet e tjera, duke përfshirë edhe numrin e personave që do të ndihmojnë në mbarëvajtjen e tij; b) t'u japë një kopje të urdhrin zyrtar për caktimin e oficerit të policisë që do të jetë përgjegjës për të ndihmuar e vëzhguar zhvillimin e tubimit. Njëkohësisht, Shefi i Komisarariatit të Policisë njofton me shkrim drejtuesin e pushtetit vendor dhe prefektin për zhvillimin e tubimit.

Neni 8, i ligji nr.8773, datë 23.4.2001 “Për tubimet” parashikon shprehimisht se: “Kur ka arsye të motivuar se zhvillimi i një tubimi në një shesh ose vendkalim publik përbën një rrezik real për sigurinë kombëtare, sigurinë publike, parandalimin e krimit, mbrojtjen e shëndetit ose të moralit ose mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të të tjerëve dhe ky rrezik nuk mund të ndalohet me masa më pak shtrënguese, shefi i komisarariatit të policisë mund të ndalojë zhvillimin e tubimit ose të vendosë për kohën dhe vendin e zhvillimit të tubimit.”

Në kushtet e përhapjes së Pandemisë së shkaktuar nga Covid-19, është miratuar Akti Normativ Nr. 3, datë 15.3.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19”, i cili ka karakter të përkohshëm dhe do të zbatohet për aq kohë sa zgjat periudha e infeksionit të shkaktuar nga Covid-19⁴. Ky Akt Normativ ka për qëllim përcaktimin dhe forcimin e zbatimit të rregullave, të vendimeve, të urdhrave dhe të udhëzimeve të nxjerra nga organet kompetente, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, për parandalimin dhe luftimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19.

Akti normativ i sipërpërmendur ka vendosur kufizime në të gjitha sferat e jetës dhe aktivitetëve, që dikur zhvilloheshin normalisht, me qëllim parandalimin dhe luftimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19. Një kufizim i tillë është vendosur edhe për zhvillimin e tubimeve apo aktivitetëve të tjera, publike. Në këtë kontekst, neni 3, pika 2, e Aktit të sipërpërmendur parashikon shprehimisht: *“Subjektet apo individët që organizojnë*

⁴ Referuar nenit 6, pika 1, të Akti Normativ Nr. 3, datë 15.3.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19”;

zhvillimin e aktiviteteve publike dhe jopublike, si aktivitete sportive, kulturore dhe konferenca, apo grumbullimet masive në vende të mbyllura apo të hapura, si koncerte, tubime dhe dëgjesa publike, dënohen me gjobë në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë për organizatorët dhe ndalimin e aktivitetit.”

Në referencë të pikës 2, të nenit 6, të këtij Akti, zbatimi i parashikimeve të tij, për kohëzgjatjen e periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, ka përparësi ndaj dispozitave të akteve të tjera lidhur me masat administrative.

Në vijim dhe në zbatim të aktit të sipërcituar është miratuar Urdhëri nr. 351, datë 29.05.2020, i Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “*Për marrjen e masave të veçanta dhe kufizimeve për parandalimin e përhapjes së Covid-19*”.

Në pikën 4, të këtij Urdhëri parashikohet shprehimisht: “*Ndalohen grumbullimet masive në vende të mbyllura apo të hapura, konferencat, tubimet, ceremonitë martesore dhe organizimet përtej familjare të ceremonive mortore deri në një urdhër të dytë*”.

Për sa më sipër, rezulton se organizimi dhe zhvillimi i tubimeve është i ndaluar kategorikisht deri në një urdhër të dytë dhe në të dy aktet e mësipërme nuk ekziston ndonjë dispozitë përjashtuese, që do të mund të lejonte subjekte të ndryshme, në kushte dhe rrethana të caktuara të zhvillojnë tubime apo aktivitetet e sipërcituara gjatë periudhës së pandemisë.

Në kontekstin e ankesës në shqyrtim rezulton se Z. R. Xh., Drejtor Ekzekutiv i “Qendresës Qytetare” i ka drejtuar kërkesë me shkrim Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, në datën 22.09.2020, ku kërkohet leje për zhvillimin e tubimit përpara Ambasadës së Kosovës, në datën 28.09.2020, ora 10:00-11:00. Me shkresën nr. R-4/2 Prot., datë 23.09.2020, Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë i ka kthyer përgjigje z. R. Xh., duke refuzuar kërkesën e tij për tubim, duke përmendur parashikimet e dispozitave të akteve të sipërpërmendura. Referuar shkresës së mësipërme citohet: “.....Në zbatim të gërmës “a”, të nenit 6 të Ligjit nr. 8773, datë 23.04.2020 “Për tubimet”, të ndalojë zhvillimin e tubimit të kërkuar nga ju në datën 28.09.2020, ora 10:00 – 11:00, në vendin e përcaktuar në kërkesë. Bazuar në kërkesat e nenit 8, të Ligjit nr. 8773, datë 23.04.2020 “Për tubimet”, zhvillimi i këtij tubimi (në kohë pandemie Covid-19) përbën një rrezik real për shëndetin tuaj dhe të qytetarëve të tjerë. Në pikën 4, të Urdhërit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 351, datë 29.05.2020 “Ndalohen grumbullimet masive në vende të mbyllura apo të hapura, konferencat, tubimet, ceremonitë martesore dhe organizimet përtej familjare të ceremonive mortore deri në një urdhër të dytë.” Ju rikujtojmë se për veprime në kundërshtim me ligjin, organizatori, drejtuesi i tubimit dhe pjesëmarrësit në tubim, do të mbajnë përgjegjësi administrative dhe penale, në

zbatim të gërmës “a”, neni 24 të Ligjit nr. 8773, datë 23.04.2020 “Për tubimet”, neni 262 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë “Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme” dhe nenit 293 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, “Pengim i qarkullimit të mjeteve të transportit”.

Njëkohësisht, edhe Z. G. S., Drejtor Ekzekutiv i Sindikatës së Punonjësve të Shërbimit Shëndetësor i ka drejtuar kërkesë me shkrim Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, në datën 23.09.2020 ku kërkohet leje për zhvillimin e tubimit përpara Spitalit nr. 1, tek QSUT “Nënë Tereza”, në datën 24.09.2020, ora 10:00. Me shkresën nr. 7033/1 Prot., datë 23.09.2020, Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë i ka kthyer përgjigje z. G.S., duke refuzuar kërkesën e tij për tubim, duke përmendur parashikimet e dispozitave të akteve të sipërpërmendura.

Referuar provave të depozituara nga të dyja palët në këtë proces hetimi administrativ rezultoi se shoqata ankuese “Qendrës për të Drejtat në Punë” nuk ka depozituar kërkesë për organizim dhe zhvillim tubimi pranë Drejtorisë së Policisë Vendore Tiranë, përgjatë periudhës kohore maj-tetor 2020, kërkesë e cila t’i jetë refuzuar nga institucioni i sipërcituar.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se Drejtoria e Policisë Vendore Tiranë ka vepruar në zbatim të parashikimeve të akteve të mësipërme nënligjore.

Përveç sa më sipër, Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë e ka informuar Komisionerin se përgjatë periudhës maj - tetor 2020 janë paraqitur 16 kërkesa nga shtetas dhe subjekte të ndryshme për organizimin e tubimeve, të cilat janë refuzuar nga ky institucion në bazë të parashikimeve të akteve të sipërpërmendura nënligjore të miratuara gjatë periudhës së Pandemisë Covid-19.

Më poshtë, jepen të dhënat e shkresave zyrtare të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë drejtuar subjekteve kërkues, që kanë depozituar kërkesë me shkrim pranë këtij institucioni, për organizim dhe zhvillim tubimi, si vijojnë:

1. Shkresa nr. 3498/1, datë 14.05.2020, drejtuar Av. A.G., Drejtor Ekzekutiv i Shtëpisë të së Drejtave të Njeriut;
2. Shkresa nr. S-95/1, datë 05.10.2020, drejtuar Presidentit të Shoqatës Kombëtare “Shpresë për të verbërit”;
3. Shkresa nr. 0-38/1, datë 29.09.2020, drejtuar shtetasve O.J. dhe A.B.;
4. Shkresa nr. XH-41, datë 11.09.2020, shtetasit XH.N.;

5. Shkresa nr. R-4/2 Prot., datë 23.09.2020, drejtuar z. R. Xh., Drejtor Ekzekutiv i “Qendresës Qytetare”;
6. Shkresa nr. K-117/2, datë 06.10.2020, drejtuar Drejtorit Ekzekutiv të Qendrës “TI”;
7. Shkresa nr. D-94/1, datë 08.10.2020, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Ligës Profesioniste të Futbollit;
8. Shkresa nr. 7197/1, datë 29.05.2020, drejtuar Federatës Kombëtare për Gjueti dhe Konservim;
9. Shkresa nr. 775/K, datë 19.10.2020, drejtuar Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet, si dhe Shoqatës Patriotike Çamëria;
10. Shkresa nr. 7033/1, datë 23.10.2020, drejtuar Sindikatës së Punonjësve të Shërbimit Shëndetësor;
11. Shkresa J-43/1, datë 15.09.2020, drejtuar shtetasit J. M.;
12. Shkresa nr. J-43/4, datë 17.09.2020, drejtuar shtetasit J. M.;
13. Shkresa nr. 7009/1, datë 22.09.2020, drejtuar Unionit Mbarëkombëtar të Integritetit të Burgosurve dhe të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë;
14. Shkresa nr. I-32/3, datë 29.06.2020, drejtuar shtetasit I.K.;
15. Shkresa nr. A-153/1, datë 04.05.2020, drejtuar Av. A.G.;
16. Shkresa nr. Z.-20/1, datë 02.10.2020, drejtuar Kryetarit të Shoqatës “Jehona Shqiptare & Autorë Projekti”.
17. Shkresa nr. A-376/1, datë 29.10.2020, drejtuar shtetasit A.G.;

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se refuzimi i kërkesës për tubim, nuk është kryer vetëm ndaj shoqatave ankuese, por edhe ndaj 14 subjekteve/shtetasve të tjerë, që kanë depozituar kërkesë me shkrim pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, për organizim dhe zhvillim tubimi, gjatë periudhës së pandemisë Covid-19.

Lidhur me zhvillimin e grumbullimeve dhe aktiviteteve të ndryshme nga ana e subjekteve politike e institucioneve publike, fotot e të cilave janë depozituar në cilësi prove nga ana e shoqatave ankuese, Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë ka sqaruar se këto aktivitete nuk janë zhvilluar me lejen e strukturave të këtij institucioni.

Në interpretim të nenit 7, pika 1 të LMD (i ndryshuar), Komisioneri gjykon se subjektet ankuese, nuk janë ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë nga ana e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pika 1, nenin 20, nenit 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” (i ndryshuar),

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të “Qendresa Qytetare” dhe Sindikatës së Punonjësve të Shërbimit Shëndetësor dhe “Qendrës për të Drejtat në Punë”, për shkakun e pretenduar në ankesë, nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkak – çdo shkak tjetër
Fusha – të mira dhe shërbime
Lloji i vendimit - mosdiskriminim